

## NJOFTIM PUNE

**Balfin Group** është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industrial, miniera e metalurgji, etj.

**Agrocon Albania Sh.p.k** është një kompani shqiptare që zhvillon aktivitetin e saj në fushën e bujqësisë. Aktivitetet përfshin prodhimin e perimeve të fresketa në serë, në fushë të hapur, grumbullimi i perimeve nga fermerët e zonës si dhe shitja me shumicë për eksport dhe në tregun shqiptar.

**Pozicioni:** Manaxher/e i Financës  
**Raporton:** Administratori i Shoqërisë  
**Shoqëria:** Agrocon Albania shpk  
**Vendndodhja:** Fshati Ngurrëz e Vogël, Lushnje

**Përmbledhje:** është përgjegjës për gjendjen financiare të shoqërisë. Prodhon raporte financiare, drejton aktivitetet e investimeve dhe zhvillon strategji e plane për qëllimet financiare afatgjata të shoqërisë.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe implementon procedura financiare, kontabël, te fatuarve, shpenzimeve dhe te kontrollit sipas direktivave të Grupit;
- Krijon dhe monitoron sistemi të brendshme kontrolli;
- Sigurohet që sistemet e të dhënave të jenë në përputhje me standardet e pranuar përgjithësisht të kontabilitetit dhe auditimit;
- Përgjegjës për manaxhimin e aseteve fikse të shoqërisë;
- Përgatit dhe dorëzon brënda afateve raportet financiare me të dhënat e shoqërisë;
- Siguron brënda afateve dhe me korrektesë raporte financiare mbi manaxhimin e kompanisë tek CEO, CFO dhe stafi i manaxhimit;
- Krijon raporte të tjera sipas kërkesës mbi kostot e ndryshme gjatë aktivitetit të shoqërisë;
- Krijon skemave të kontabilitetit të kostos në përputhje me standardet e industrisë;
- Mbikëqyrja e kontabilitetit, duke u siguruar që kostot reale të jenë të paraqitura në

mënyrë të saktë për qendrat e kostos dhe rezultatet e përgjithshme të prodhimit dhe përfitueshmëria janë gjurmuar dhe raportuar në mënyrë të saktë dhe me kohë;

- Të ndërveproj me menaxherët e tjerë për të ofruar mbështetje përmes analizave, raporteve dhe rekomandimeve financiare dhe të informacionit;
- Monitoron rigorozisht kostot e prodhimit, raporton mbi ndryshimet dhe zonat e caktuara për reduktimin / efikasitetin e kostove;
- Mbikëqyrë miratimin dhe përpunimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe pagesave;
- Sigurohet që bilancet e palëve të lidhura dhe vëllimet e transaksioneve të rregullohen rregullisht;
- Parashikon rrjedhjen e parasë dhe nevojave, sigurohet që të ketë fonde të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat operacionale dhe kapitale;
- Ruan marrëdhënien bankare për operacionet e përditshme dhe menaxhimi i duhur i llogarive bankare;
- Kujdeset për përmirësim e sistemeve të informacionit të automatizuar financiar për kompaninë;
- Mentoron / trajnon personelin nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë;
- Detyra të tjera të caktuara.

### **Kërkesa dhe kualifikime**

**Edukimi:** Diplomë universitare në degën e Financë/Kontabilitet

**Eksperiencë Pune:** Minimalisht 5 vjet eksperiencë progresive në fushën e kontabilitetit të shoqërive private dhe minimalisht 2 vjet eksperiencë në manaxhimin e personelit;

### **Kualifikime të tjera:**

- Eksperiencë të mëparshme në fushën e bujqësisë përbën avantazh;
- Njohuri shumë të mira për gjuhën shqipe dhe anglishte;
- Eksperiencë në manaxhimin dhe kontabilizimin e kostos;
- Aftësi të forta teknike në kontabilitet, dhe raporte të menaxhimit;
- Aftësi të forta analitike dhe tolerancë ndaj stresit;
- I/E Vetë-motivuar, i/e aftë për të udhëhequr dhe motivuar punonjësit;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese, të zotërojnë etikë pune dhe integritet;
- Të ketë patentë për drejtimin e automjetit.

### **Procedura e aplikimit:**

Për të aplikuar për këtë pozicion, jeni të lutur të dërgoni CV tuaj nëpërmjet emailit tek adresa [hr@agroconalbania.al](mailto:hr@agroconalbania.al)

**Afati i dorëzimit:** 17 Tetor 2017

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr.9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi "Mbrojtjen e të dhënave personale".